



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	01.04.2021	1	viti god year
Organ /Mësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIDNESHKE	1585/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.183/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në përbërë nga: Jeton Koca-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2182/2019 të datës 11.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 25.03.2021, ka shqyrtuar ankesën A.nr.278/2019 të datës 16.05.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Haxhi Salihu", Komuna e Gjilanit, kundër organit të punësimit/Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1, si dhe nenit 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 01.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.278/2019 e datës 16.05.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 144 i datës 27.02.2019 i Kryetarit të Komunës së Gjilanit, dhe Vendimi me numër Nr.016-44542 i datës 18.04.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit.

A r s y e t i m

Ankuesi Inspektor i Ndërtimit pran Drejtorise per Urbanizem, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjilanit, me datë 16.05.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2320/2019 të regjistruar me numër A.nr.278/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 144 të datës 27.02.2019 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, për ndërprerje te marrëdhënies se punës dhe Vendimit Nr.016-44542 të datës 18.04.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me

datë 16.05.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjilanit. Këshilli me datë 27.05.2019 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave për marrjen e vendimit meritot administroj këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.2182/2019 të datës 11.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me datë 25.03.2021 dhe protokolluar me numër 1375/2021; Ankesën me numër protokoll 2320/2019 të datës 16.05.2019 të regjistruar me numër Anr.278/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 18.04.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi numër 144 të datës 27.02.2019 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Kërkesën e datës 01.03.2019 për mbrojtje të ligjshmërisë, bashkangjitur shkresa e mbrojtësit të ankuesit; Kërkesë e datës 16.04.2019 për mbrojtje të ligjshmërisë për Gjykatën Supreme; Pliko/zarf e postës së Kosovës me nr. R7160725 të datës 14.05.2019; Përgjigje në ankese e datës 27.05.2019; Vendimi i datës 15.03.2016 për pezullim parandalues; Aktgjykimin PKR nr.232/17 të datës 26.06.2018 të Gjykata Themelore/Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykim PAKP nr.364/2018 të datës 29.11.2018 të Gjykatës se Apelit; Fletë-kthesë nr. 02/016-44542 të datës 23.04.2019; Pliko/zarf e datës 24.05.2019 me numër R7162870.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në Aktgjykimin me numër PKR nr.232/17 të datës 29.11.2018 të Gjylates Themelore në Gjilan, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është shpallur fajtor për veper penale marrje e ryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 të KPRK-se, dhe i njejtë është denuar me denim me burg në kohezgjatje prej 2 (dy) vite, dhe i është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administratën publike në periudhë prej 2 viteve pas mbajtjes së denimit me burg, ndersa me Aktgjykimin numër PAKR nr.364/2018 të Gjykates se Apelit, është vertetuar Aktgjykimi PKR nr.232/17 i datës 29.11.2018 i Gjykates Themelore në Gjilan.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, pas njoftimit lidhur me aktgjykimet si me lartë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Sherbimin Civil, me datë 27.02.2019 ka nxjerr Vendimin me numër protokoll 144 për përfundimin e marrëdhënies së punës ndaj ankuesit

Kundër Vendimit me numër protokoll 144 të datës 27.02.2019, ankuesi me datë 20.03.2019 ka parashtruar ankesë pranë Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Gjilanit. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 18.04.2019 ka nxjerr Vendimin me numër Nr.016-44542, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankuesit të datës 20.03.2019 dhe ka lënë në fuqi Vendimin me numër protokoll 144 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.016-44542 të datës 18.04.2019 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 16.05.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të drejte të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, për faktin se ankuesi pretendon se përfundimi i marrëdhënies së punës është bërë ende pa u shterur të gjitha mjetet juridike sepse i njëjti ka dëshmuar se ndaj vendimit dënues është ushtruar mjeti i jashtëzakonshëm/Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë pran Gjykatës Supreme.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi me aktgjykim të formes se prerë është shpallur fajtor për veper penale marrje e ryshfetit nga neni 428 paragrafi 1 të KPRK-se, dhe i njejtë është denuar me denim me burg në kohezgjatje prej 2 (dy) vite, dhe i është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administraten publike në periudhe preje 2 viteve pas mbajtjes se denimit me burg. Andaj, meqense perfundimi i mardhenies se punes se ankuesit eshte berë pasi që aktgjykimi denues eshte bërë i formes se prerë, Kolegji konstaton se Kryetari i Komunës së Gjilanit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli 144 të datës 27.02.2019 për përfundimin e marrëdhënies se punës ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 90, ku përcaktohet se: 1. *Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucioni.* 2. *Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon me: 2.4. dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë për mbajtjen e burgut efektiv për gjashtë (6) muaj e më tepër, si dhe në pajtim me nenin 11 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nen paragrafi 2.4 si dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr.01/2011 për Ndërprerje, Pezullim dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.* Kolegji po ashtu ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Gjilanit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.016-44542 të datës 18.04.2019, për refuzimin e ankesës se ankuesit, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.183/2021.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

